



PROCESVERBAL I DEBATI PUBLIK

Mbajtur me datë 15.08.2024 në "Shtëpinë e Kulturës". Ashtu siç ishte paralajmëruar nëpërmes informimit debati publik filloi në ora 11:00 prezent ishin 18 qytetarë. Prezent ishte Nënkryetari i Komunës z. Sevdin Dernjani.

Takimin e kryesoj Drejtoresha Buxhet dhe Financa znj. **Lindita Ballazhi**.

Rendi i Punës

1. Projekt Buxheti për vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026-2027.

Lindita Ballazhi para se me vazhduar me prezantimin e buxhetit fillimisht kërkoj nga nënkryetari i Komunës për një fjalë përshëndetëse, pastaj do të bëjë prezantimin e buxhetit.

Sevdi Dernjani është obligim ligjorë që të organizojmë dëgjim buxhetorë për planifikimin buxhetorë për vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026-2027. Për shumën e mjeteve financiare që planifikohen për paga dhe shtesa buxheti, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere, investime kapitale do të shpjegon drejtoresha për Buxhet dhe Financa dhe pastaj ti jepni propozimet e juaja. Sa i përket shpenzimeve buxhetore problem në këtë vit por edhe në vitin tjetër do ta kemi çështjen e kontratës kolektive e cila do të na shkakton probleme që është nënshkruar nga Qeveria dhe Sindikatat e që po na shkakton probleme e që në këtë vit 162 000.00 € janë marrë prej përmbaruesve për çështjen e kontratës kolektive.

Lindita Ballazhi Buxheti paraqet një instrument financiar apo një plan njëvjeçar për ecurinë e të hyrave dhe shpenzimeve vjetore të Organizatës Buxhetore. Fazat nëpër të cilat i kemi kaluar deri në hartimin e buxhetit janë:

- Themelimi i 2 grupeve punuese: Grup punues për hartimin e dëgjimeve buxhetore dhe Grupi punues për hartimin e KAB-it 2025-2027.
- Pranimi i Qarkores Buxhetore 01/2025 me kufijtë fillestar buxhetor,
- Hartimi i KAB-it me grupin punues,
- Mbajtja e dëgjimeve buxhetore për KAB 2025-2027,
- Miratimi i KAB-it në Kuvend Komunal,
- Dorëzimi i KAB-it në Departamentin e Buxhetit - MFPT,
- Pranimi i Qarkores Buxhetore 02/2025 me kufijtë final buxhetor,
- Hartimi i Draft Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027,
- Mbajtja e Dëgjimeve Buxhetore për Draft Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027,
- Dorëzimi i Draft Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027 para datës 01.09.2024 në Kuvend Komunal,

- Miratimi i Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027 në Kuvend Komunal,
- Dorëzimi i Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027 në Departamentin e Buxhetit - MFPT.

Buxheti për vitin 2025 është në shumë prej 3,615,457.00 €, ky buxhet është ndarë në kategoritë buxhetore. Për paga dhe shtesa buxheti i planifikuar është në shumë prej 2,188,542.00 €, mallra dhe shërbime 584,500.00 €, shpenzime komunale 94,000.00€, subvencione dhe transfere në shumë prej 143,000.00 €, investime kapitale 605,415.00 €.

Sa i përket listës së projekteve kapitale, i kemi listuar të gjitha projektet të cilat janë miratuar nga Asambleja Komunale në KAB 2025-2027, po ne jemi të hapur edhe për propozime të reja. Më pas do të hartojmë Listën e propozimeve të qytetarëve dhe të njëjtën listë do ta dorëzojmë së bashku me Buxhetin në Kuvend Komunal për shqyrtim dhe aprovim të mëtutjeshëm.

Xhevahir Dernjani propozoj që të bëhet rregullimi i prockave në fshatin Paldenicë, të bëhet trotuar në rrugën e Paldenicës prej shkollë deri në fshatë. Rregullimi i parkut te shkolla fillore “Kështjella e Diturisë”.

Mevludin Kuka propozoj që të bëhet rruga buzë Lepencit, të shtrohet me zhavorr rruga nën breg, rivitalizimi i kroi të fshatit Seçishtë.

Ali Axhami propozoj që të asfaltohet rruga “Egzodi 99” për vitin 2025”, rregullimi i kanalizimit nga stacioni i ri i policisë deri në qendër.


Kushtrim Loku propozoj që të rregullohen edhe rrugët malore të cilat i lidhin pjesët rekreative të shtrohen me zhavorr.

Lindita Ballazhi a keni edhe ndonjë propozim përveç këtyre propozimeve , nëse nuk ka propozimet që u parashtuan do t’i analizojmë si ekzekutiv dhe do t’i përcjellim për Kuvend.

Debati përfundoi në ora 11:52.

Procesmbajtësi

Avni Bushi



Drejtoresh për Buxhet dhe Financa

Lindita Ballazhi

